

FUQI PËRMES LUTJES

E. M. Bounds

Përktheu nga origjinali
Asim Hamza

Botime "STREHA" 2015

Original Title
Power Through Prayer
by E. M. Bounds

Përktheu nga origjinali: Asim Hamza
Kopertina: Ditjon Dibra

Copyright në Gjuhën Shqipe
© Botime "STREHA" 2015

Të gjitha citimet biblike, nëse nuk thuhet ndryshe, janë marrë nga Bibla,
Diodati i Ri (1991-1994), përdorur me leje nga Albanian Bible Society
(A.B.S.)

Të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet,
të vendoset në ndonjë sistem, ose të transmetohet nëpërmjet çdo forme apo
mënyre elektronike, mekanike, fotokopjimi, inçizimi apo në ndonjë mënyrë
tjetër pa marrë më parë leje me shkrim nga botuesi.

Tirazhi: 500 kopje

ISBN 978-9928-4289-5-0

Përmbajtja

Parathënie	v
1 Nevojiten njerëz të lutjes	1
2 Aftësia jonë është prej Perëndisë	9
3 Shkronja vret	15
4 Prirje për t'u mënjanuar	21
5 Lutja - thelbësorja e madhe	27
6 Një shërbesë e suksesshme lutjeje	33
7 Lutjes i duhet kushtuar shumë kohë	39
8 Shembuj njerëzish të lutjes	45
9 Niseni ditën me lutje	51
10 Lutja dhe devotshmëria të bashkuara	55
11 Një shembull devotshmërie	61
12 Përgatitja e zemrës është e nevojshme	67
13 Hir prej zemrës dhe jo prej mendjes	73
14 Domosdoshmëria e vajosjes	79
15 Vajosja - Shenja e predikimit të vërtetë të Ungjillit	85
16 Çmimi i vajosjes është shumë lutje	91
17 Lutja karakterizon udhëheqjen frymërore	97
18 Predikuesit kanë nevojë për lutjet e besimtarëve	103
19 Këmbëngulja është e domosdoshme për rezultate më të mëdha në lutje	111
20 Predikuesi që lutet lind besimtarë që luten	119

Parathënie

Për më tepër se një shekull librat e Edward McKendree Bounds rreth lutjes i kanë nxitur dhe frymëzuar të krishterët të bëhen luftëtarë lutjeje.

Për shkak se E. M. Bounds e praktikoi me aq shumë zell atë që predikoi ishte në gjendje të kapte thelbin e lutjes dhe për këtë arsye veprat e tij vazhdojnë të ekzistojnë për t'u bërë thirrje të krishterëve të sotëm drejt një dishepullizimi më të lartë dhe një jete më të gjallë lutjeje.

Fuqi Përmes Lutjes është quajtur “një prej kryeveprave vërtet madhështore rreth temës së lutjes.” Termi klasik mund të përdoret me vend për këtë libër të jashtëzakonshëm.

Përmes njëzet kapitujve frymëzues dhe provokues që fillojnë me citime nga gjigantë frymërorë, E. M. Bounds thekson domosdoshmërinë e lutjes jetësore në jetën e pastorit. Ai thotë, “...çdo predikues që nuk e bën lutjen faktor të fuqishëm në jetën dhe shërbesën e tij është vetë një faktor i dobët në punën e Perëndisë dhe është i pafuqishëm për ta çuar përpara çështjen e Perëndisë në këtë botë.”

“Shkrimet e E. M. Bounds janë puse të pashtershme nga të cilët mund të nxirrni ujë frymëror gjatë gjithë jetës tuaj. Ato janë thesare të fshehura të formuara në errësirën e agimit dhe në nxehtësinë e mesditës mbi kudhrën e përjetimit duke marrë një

formë të mrekullueshme prej goditjeve të fuqishme të hyjnores. Janë zëra të gjallë përmes të cilëve, edhe pse i vdekur, ai ende vazhdon të flasë."

Claude L. Chilton Jr.

"Nëse dëshironi të frymëzoheni për t'u lutur por nuk keni kohë për një libër të gjatë, ja tek keni një të shkurtër. Ka të ngjarë që asnjë libër tjetër nuk ka pasur një ndikim më të madh në jetën time të lutjes në raport me madhësinë e tij sesa libri *Fuqi Përmes Lutjes* nga E. M. Bounds"

John Piper

Kapitulli 1

Nevojiten njerëz të lutjes

*Ushtroni shenjtërinë universale të jetës. Gjithë dobia
juaj varet prej kësaj, pasi predikimet tuaja mund të
zgjasin një apo dy orë, por jeta juaj predikon gjithë javën.
Nëse Satani mund ta bëjë një shërbyes lakmues, kërkues
lavdërimesh, kënaqësish, ushqimi të mirë, ia ka
shkatërruar shërbesën. Kushtojani veten lutjes, dhe tekstet,
mendimet dhe fjalët tuaja merrini prej Perëndisë.
Luteri i kalonte tre orët e tij më të mira në lutje.*

- Robert Mëri MekÇejn

Ne jemi vazhdimisht të prirur, për të mos thënë të fiksuar, për të shpikur metoda të reja, plane të reja, organizata të reja për ta çuar kishën përpara dhe kështu të sigurojmë zgjerim dhe efektshmëri për ungjillin. Kjo rrymë e kohës ka prirjen për të lënë mënjane njeriun apo ta humbasë atë në mes të planit apo organizatës. Plani i Perëndisë është ta bëjë njeriun të madh, shumë më tepër atë se çdo gjë tjetër. Njerëzit janë metoda e Perëndisë. Kisha po kërkon metoda më të mira, Perëndia po kërkon njerëz më të mirë. “Qe një njeri i dërguar nga Perëndia, emri i tij ishte Gjon.” Epoka që lajmëroi dhe përgatiti udhën për Krishtin ishte e lidhur me atë njeri Gjonin. “Sepse na ka lindur një fëmijë, një djalë na është dhënë.” Shpëtimi i botës vjen prej atij Biri në djep. Kur Pali i bën thirrje karakterit personal të burrave që e rrënjosën ungjillin në botë, ai e zgjidh misterin e suksesit të tyre. Lavdia dhe efektshmëria e ungjillit varet prej njerëzve që e shpallin atë. Kur Perëndia shpall se “Zoti me sytë e tij shikon përpara dhe mbrapa tërë dheun për të treguar forcën e tij ndaj atyre që kanë një zemër të ndershme ndaj tij,” ai shpall nevojën për njerëzit dhe varësinë e tij tek ata si kanale përmes të cilëve të ushtrojnë fuqinë e tij mbi botë. Kjo e vërtetë jetësore dhe urgjente është ajo të cilën kjo epokë e teknologjisë priret ta harrojë. Harrimi i saj është një mallkim në punën e Perëndisë ashtu si do të ishte heqja e diellit nga kupa qiellore. Errësira, konfuzioni dhe vdekja do të pasonin.

Ajo për të cilën kisha ka nevojë sot nuk është më tepër teknologji apo teknologji më të mirë, nuk ka nevojë për organi-

zata të reja apo për më tepër metoda të reja, ajo ka nevojë për njerëz të cilët Fryma e Shenjtë mund t'i përdorë, njerëz të lutjes, njerëz të fuqishëm në lutje. Fryma e Shenjtë nuk derdhet përmes metodave, por përmes njerëzve. Ai nuk zbret mbi makineri, por mbi njerëz. Ai nuk vajos plane por njerëz, njerëz të lutjes.

Një historian i kohëve të fundit ka thënë se aksidentet e karakterit personal kanë të bëjnë më tepër me revolucionet e kombeve nga sa mund ta pranojnë historianët filozofë apo politikanët demokratikë. Kjo e vërtetë gjen zbatim të plotë në ungjillin e Krishtit, karakteri dhe sjellja e ndjekësve të Krishtit janë ato që e sjellin Krishtin tek bota, transformojnë kombe dhe individë. Kjo është drejtpërsëdrejti e vërtetë për predikuesit e ungjillit.

Karakterit dhe fatet e ungjillit i janë besuar predikuesit. Ai ose e përforcon ose e prish mesazhin që ka marrë nga Perëndia për njerëzit. Predikuesi është tubi i artë përmes të cilit rrjedh vaji hyjnor. Tubi jo vetëm që duhet të jetë i artë, por i hapur dhe pa të meta, në mënyrë që vaji të ketë një rrjedhë të plotë, të papenguar dhe të mos shkojë dëm.

Njeriu bën predikuesin. Perëndia duhet të bëjë njeriun. Nëse është e mundur, lajmëtari është më tepër se mesazhi. Predikuesi është më tepër se predikimi. Predikuesi e bën predikimin. Ashtu si qumështi jetëdhënës nga gjiri i nënës është jeta e saj, kështu gjithë sa thotë predikuesi është e ngjyrosur dhe e mbarsur prej faktit se çfarë është predikuesi. Thesari gjendet në enë prej balte, kështu shija e enës e mbars dhe mund t'ia ndryshojë ngjyrën. Njeriu, i gjithë njeriu, qëndron pas predikimit. Predikimi nuk është shfaqja e një ore. Ai është rrjedha e një jete. Duhet njëzetë vjet për të bërë një predikim, për shkak se duhen njëzetë vjet për të formuar njeriun. Predikimi i vërtetë është një gjë jete. Predikimi rritet për shkak se njeriu rritet. Predikimi është i fuqishëm për shkak se njeriu është i fuqishëm. Predikimi është i shenjtë

për shkak se njeriu është i shenjtë. Predikimi është plot vajosje hyjnore për shkak se njeriu është plot vajosje hyjnore.

Pali e quajti “Ungjilli im,” jo që ai e kishte ulur përmes prirjeve të tij çuditshme apo ta kishte devijuar përmes përqafimit egoist, por ungjilli u vendos në zemrën dhe gjakun e këtij njeriu Palit, si një amanet personal që duhej të ushtrohej përmes cilësive të tij Paliane, të ndizej flakë dhe të fuqizohej prej energjisë së zjarrtë të shpirtit të tij përvëlues. Çfarë ishin predikimet e Palit? Ku gjenden ato? Skelete, fragmente të shpërndarë që pluskojnë në detin e frymëzimit! Por njeriu Pal, më i madh se predikimet e tij, jeton përjetë, në një formë, pamje dhe shtat të plotë, me dorën e tij që i jep formë kishës. Predikimi është thjesht një zë. Zëri humbet në heshtje, teksti harrohet, predikimi rrëshqet nga kujtesa, predikuesi jeton.

Predikimi nuk mund të ngrihet me forcat e tij jetëdhënëse më lart se predikuesi. Njerëzit e vdekur japin predikime të vdekura dhe predikimet e vdekura vrasin. Gjithçka varet nga karakteri frymëror i predikuesit. Në epokën Judease kryepriifti kishte të gdhendura me shkronja margaritarësh në një pllakë ari, “Shenjtëruar Zotit.” Kështu edhe çdo predikues në shërbesën e Krishtit duhet të formohet dhe të zotërohet prej së njëjtës motoje të shenjtë. Është për të ardhur turp që shërbesa e krishterë të bjerë më poshtë në shenjtërinë e karakterit dhe synimit se priftëria e Judenjve. Xhonatan Eduards tha, “Vazhdova në kërkimin tim të zellshëm për më tepër shenjtëri dhe përngjasim me Krishtin. Qielli që dëshiroja ishte qiell shenjtërie.” Ungjilli i Krishtit nuk lëviz përmes valëve popullore. Nuk ka fuqi vetë propaganduese. Ai lëviz ndërsa njerëzit që e zotërojnë atë lëvizin. Predikuesi duhet ta mishërojë ungjillin. Cilësitë e tij hyjnore dhe më të dallueshme duhet të mishërohen tek ai. Fuqia shtrënguese e dashurisë duhet të gjendet tek predikuesi si një forcë treguese, e pazakontë, gjithë

urdhëruese dhe që e harron veten. Energjia e vetëmohimit duhet të jetë qenia e tij, zemra, gjaku dhe kockat e tij. Ai duhet të dalë si burrë mes burrave, i veshur me përlësi, të qëndrojë në butësi, i urtë si gjarpër, i pastër si pëllumb, me zinxhirët e një shërbëtori dhe shpirtin e një mbreti, një mbreti të madh dhe fisnik, në durim të qëndrueshëm, me thjeshtësinë dhe ëmbëlsinë e një fëmije. Predikuesi duhet të hidhet me gjithë dorëzimin e një besimi të përsosur që e zbraz veten dhe me një zell që e konsumon në punën e tij për shpëtimin e njerëzve. Burrat që e kapin dhe i japin formë një brezi për Perëndinë duhet të jenë me zemër, heroikë, të dhembshur dhe martirë të patrembur. Nëse janë njerëz të ndrojtur që bëjnë detyrën, që u pëlqejnë apo u druhen njerëzve, nëse besimi i tyre ka një lidhje të dobët me Perëndinë dhe Fjalën e tij, nëse mohimi i tyre thyet prej çfarëdo prirjeje të vetes apo të botës, ata nuk mund ta qeverisin kishën dhe as nuk mund ta fitojnë botën për Perëndinë.

Predikimi më i fortë dhe i mprehtë i predikuesit duhet të jetë ndaj vetes së tij. Puna e tij më e plotë, më e mundimshme, më delikate dhe më e vështirë është me veten e tij. Trajnimi i të dymbëdhjetëve ishte puna e madhe e vështirë dhe e vazhdueshme e Krishtit. Predikuesit nuk janë bërës predikimesh, po bërës njerëzish dhe shenjtorësh, dhe i vetmi që është trajnuar mirë për këtë punë është ai që e ka bërë veten njeri dhe shenjtor. Nuk janë talentet e mëdha, shkollimi i shkëlqyer apo predikuesit e shkëlqyer për të cilët Perëndia ka nevojë por, njerëz të mëdhenj në shenjtëri, të mëdhenj në besim, të mëdhenj në dashuri, të mëdhenj në besnikëri, të mëdhenj për Perëndinë, njerëz që gjithmonë predikojnë me predikime të shenjta në podium dhe me jetë të shenjta jashtë tij. Këta mund t'i japin formë një brezi për Perëndinë.

Në këtë mënyrë u formuan të krishterët e hershëm. Ata ishin

burra të një forme solide, predikues sipas llojit qiellor, heroikë, të fuqishëm, luftëtarë, shenjtorë. Predikimi me ta do të thoshte vetëmohim, vetë-kryqëzim, serioz, me mund, punë martirësh. Ata iu kushtuan predikimit në një mënyrë që i foli brezit të tyre dhe në barkun e tij formoi një brez për Perëndinë që nuk kishte lindur ende. Predikuesi duhet të jetë lutës. Lutja është arma më e fuqishme e predikuesit. Ajo është një forcë e plotfuqishme në vetvete, ajo i jep jetë dhe forcë gjithçkaje.

Predikimi i vërtetë bëhet në dhomëzën e lutjes. Njeriu, njeriu i Perëndisë bëhet në dhomëz. Jeta dhe bindjet e tij më të thella lindën në bashkësinë e tij të fshehtë me Perëndinë. Agonia e rëndë dhe me lot e shpirtit të tij, mesazhet e tij me më tepër peshë dhe më të ëmbla u morën kur ishte vetëm me Perëndinë. Lutja e bën njeriun, lutja e bën predikuesin, lutja e bën pastorin. Podiumi i sotëm është i dobët në lutje. Krenaria e të nxënit shkon kundër përlësisë së varur të lutjes. Lutja në podium shumë shpesh është thjesht zyrtare, një shfaqje për rutinën e shërbesës. Për podiumin modern lutja nuk është ajo forcë e fuqishme që ishte për jetën dhe shërbesën e Palit. Çdo predikues që nuk e bën lutjen një faktor të fuqishëm në jetën dhe shërbesën e tij është vetë faktor i dobët në punën e Perëndisë dhe i pafuqishëm për ta çuar përpara çështjen e Perëndisë në botë.

